

MONITORIMI KOMBËTAR 2018

2018



IMPLEMENTIMI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT NGA BASHKITË E SHQIPËRISË

Realizuar nga:



Mbështetur nga:



Financuar nga:



SWEDISH INTERNATIONAL DEVELOPMENT
COOPERATION AGENCY

MONITORIMI KOMBËTAR 2018

**IMPLEMENTIMI I INFRASTRUKTURËS ZBATUESE
TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
NGA 61 BASHKITË E SHQIPËRISË**



Seria e Studimeve dhe botimeve nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP

Shtator, 2018

Të gjitha të drejtat e rezervuara
Copyright: **Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP**

Materiali që përmban ky publikim nuk mund të kopjohet apo riprodhohet ne asnje rrethane.
Te dhenat qe permban ky raport mundet vetëm
të citohet me kusht që të njihet/citohet autorësia e tij përmes referimit të plotë ne tekst të atributeve te autorit
Një kopje e publikimit që përmban materialin e referuar duhet t'i dërgohet INFOÇIP.
Çdo perdorim i parashtrimeve teorike apo i gjetjeve që përmban ky studim,
pa leje dhe/ose nga të tretë është i ndaluar dhe subjekt penalizimi nga legjislacioni ne fuqi per te drejten e autorit

Drejtor i research-it & autor i metodës:

Gerti Shella

Stafi i përfshirë në studim

Altea Krajka
Dao Zela
Donaltina Vila

Designer, Layout, Print

INFOCIP

Publikuar në Tiranë nga Qendra per Çeshtje të Informimit Publik

Mbeshtetur nga:



Gjetjet e këtij Raporti janë vetë të INFOÇIP dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikpamjet dhe / apo konkluzionet e Qeverisë Suedeze dhe / apo të Olof Palme Center në fushën për të cilin ndërmerret ky monitorim.

“E drejta e informimit është e garantuar”
Neni 23, pika 1, Kushtetuta e Shqipërisë

I. KUADRI LIGJOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË SHQIPËRI

Republika e Shqipërisë ofron garanci të plota ligjore dhe kushtetuese për të drejtën e informimit. Shqipëria hyn ndër ato pak vende të cilat e kanë ngritur në nivelin e normës kushtetuese¹ këtë të drejtë. Në vitin 2014 Shqipëria përmirësoi dukshëm kuadrin ligjor për të drejtën e informimit duke adoptuar ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”². Ky hap u ndërmor edhe si një kërkesë konstante e shoqërisë civile shqiptare, për t’i dhënë një shans real zbatimit praktik të garancive kushtetuese ekzistuese, të cilat kishin hasur vështirësi serioze me Ligjin nr. 8503, datë 30/06/1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare.

Ligji aktual 119/2014 mbart risi të cilat dukshëm synojnë të sigurojnë zbatimin praktik të së drejtës së informimit në Shqipëri, si dhe një sistem të llogaridhënies lidhur me të. Më të rëndësishmet ndër to janë:

- *Garantimi i të drejtës për informim pa shpjeguar motivet;*
- *Përcaktimi i dy kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe me kërkesë;*
- *Hartimi dhe miratimi i programeve të transparencës, ku përfshihen kategoritë e informacionit publik pa kërkesë;*
- *Roli i koordinatorit për të drejtën e informimit dhe parashikimi i kompetencave të tij;*
- *Afate të reja për shqyrtimin e kërkesave për informim si dhe ankesave që depozitohen pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;*
- *Parashikimet e rasteve të kufizimit të së drejtës për informim;*
- *Gjoha dhe sanksione administrative për të rritur llogaridhënien e autoriteteve publike .*

Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ka atribuar, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit kompetenca për të shqyrtuar ankesa, për të kryer hetime administrative, për të zhvilluar seanca dëgjimore me palët e deri në vendosjen e

¹ E drejta për informim është e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; Kreu II, Liritë dhe të Drejtat Vetjake, neni 23 parashikon si më poshtë vijon:

1. *E drejta e informimit është e garantuar.*
2. *Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin , të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore , si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.*
3. *Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.*

² Ligji i ri 119/2014 “për të drejtën e Informimit” u miratua në seancë plenare në datë 18.09.2014 me 78 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim. Ligji i ri hyri zyrtarisht në fuqi 15 ditë pas botimit, konkretisht në datë 2 Nëntor 2014.

sanksioneve (dënimit) me gjoba. Ligji i ri zgjeron numrin e subjekteve që kanë detyrimin për të vënë në dispozicion të qytetarëve informacion, duke filluar që nga institucionet e pushtetit qendror, pushtetit vendor, sistemi gjyqësor dhe prokuroritë e deri të shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve.

Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar programin e transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Parimi i aksesit të lirë në informacion dhe barazisë së kushteve për akses në të është një tjetër avantazh i rëndësishëm që siguron ligji shqiptar. Qasja proaktive në informacionin zyrtar përmes përdorimit të faqeve zyrtare të internetit mundëson akses maksimal, në njëjtën kohë, për numër të papërcaktuar subjektesh apo qytetarësh. Kjo lehtëson barrën e sporteve, shkurton rradhët dhe rrit efikasitetin e administratës. Kufizimet mbi aksesin në dokumenta zyrtare janë parashikuar gjithashtu në ligj duke synuar balancën midis interesit publik dhe dëmit që mund të vijë nga dhënia e informacionit.

Ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” promovon qasjen për dhënien e informacioni pa kërkesë. Ligji detyron autoritetin publik të hartojë dhe miratojë programin institucional të transparencës. Ky Program konsiston në tërësinë e informacionit që duhet të bëhet publik *ex officio* (pa kërkesë). Titullari i organit publik duhet të miratojë: **a**) kategoritë e informacionit që duhet të bëhet publik *ex officio*, dhe **b**) mënyrat apo modalitetet e bërjes publike të tij nga ana e autoritetit publik.

Autoriteti publik duhet ta përgatisë këtë informacion paraprakisht në një format lehtësisht të kuptueshëm dhe të aksesueshëm, dhe ta publikojë në faqen përkatëse të internetit. Programet e transparencës duhet të rishikohen periodikisht në varësi të natyrës së autoritetit publik në fjalë, por jo më vonë se çdo 5 vjet.

Ndër risitë e tjera pozitive të ligjit të ri 119/2014 është përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe njohja zyrtare e përdorimit të formateve dixhitale. Blloqet kryesore të implementimit të ligjit, sic janë Programet e Transparencës, informacioni i ofruar në mënyrë proaktive, kontaktet e koordinatorëve të së drejtës për informim, si dhe regjistri i pyetje-pergjigjeve duhet të jenë të publikuar në faqet zyrtare në internet të autoritetit publik por edhe të autoritetit mbikqyrës.

Ligji caktoi afatin 6 muaj për implementimin e këtyre programeve³. E përkthyer në data konkrete, data 3 Maj 2015, duhet të ishte afati i fundit për autoritetet publike, përfshirë NJQV-të për të garantuar zbatimin e kërkesave të ligjit 119/2014.

³ Neni 4 “Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës” 1. Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

II. E DREJTA E INFORMIMIT DHE QEVERISJA VENDORE

Ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” nuk gjeti zbatim të menjëhershëm në nivel të qeverisjes vendore. Disa muaj para miratimit të tij, më 31 Korrik 2014, Kuvendi miratoi ligjin 115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në RSH”. Ndarja e re krijonte 61 bashki (në vend të 373 bashki+ komuna) në nivelin e parë të qeverisjes vendore.

Në këto kushte, implementimi i ligjit 119/2014 në nivel vendor ishte i kondicionuar objektivisht të fillonte pas bërjes efektive të ndarjes së re administrativo-territoriale. Kjo e fundit u aktivizua nga Zgjedhjet Vendore të 21 Qershorit 2015, të cilat prodhuan vetëm 61 bashki të mëdha në të gjithë territorin e RSH. Konstituimi i organeve të reja të qeverisjes vendore përfundoi në periudhën Korrik-Shtator 2015, ose rreth më pak se një vit nga hyrja në fuqi e ligjit të ri 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Për t’ju përgjigjur realitetit të ri të krijuar nga RAT në nivel vendor, Kuvendi miratoi në 5 Dhjetor 2015 edhe një ligj krejt të ri kuadër “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”. Ligji i ri 139/2015 ka integruar për herë të parë një kapitull ligjor të dedikuar për Transparencën në nivel vendor. Kreu VI i ligjit në fjalë përcakton qartësisht detyrimin për të garantuar të drejtën e informimit dhe të drejtën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen e organeve të qeverisjes vendore.

Në nenin 15 të këtij ligjit 139/2015 është përcaktuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara për njoftimet publike. *Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.*

Neni 18 i ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: *“Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim”.*

Aktualisht është kërkuar që ligji 119/2014 t’i nështrohet disa amendimeve për të fuqizuar edhe më shumë rolin e autoritetit mbikqyrës si dhe për të përcaktuar më qartë përgjegjësinë ligjore dhe administrative brenda institucionit publik në kushtet kur këtij të fundit i kërkohet informacion.

III. E DREJTA E INFORMIMIT NË BASHKI DHE INFOCIP

Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOCIP realizoi në vitin 2016 të parim monitorim kombëtar lidhur më implementimin e infrastrukturës zbatuese të ligjit 119/2014 në 61 bashkitë e reja të krijuara pas aktivizimit të ndarjes së re administrativo-territoriale. Monitorimi maste dhe vlerësonte 5 komponentët kryesorë që e bëjnë ligjin në fjalë të zbatueshëm, duke filluar nga caktimi i një koordinatori për të dretën për informim, hartimi i programeve të transparencës dhe deri tek regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve. Faqet e internetit, që përfaqësojnë infrastrukturën bazë që mundëson publikimin proaktiv gjithashtu u vlerësuan për herë të parë me një metodë që përfaqësoi një risi në fushën e monitorimeve të këtij lloji. INFOCIP dizajnoi një metodologji vlerësimi *sui-generis*, “të qepur pas trupit” të ligjit të ri 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” përmes së cilës vlerësohet shkalla e implemmentimit të infrastrukturës mundësuese.

Metoda e hartuar nuk synon të matë dhe vlerësojë cilësinë e informacionit të ofruar nga bashkitë kundrejt kërkesës për informim, pasi INFOCIP vlerëson se kjo është një detyrë ligjore e Komisionerit për të Drejtën për Informim. Nga ana tjetër, infrastruktura mundësuese, në frymën dhe gërmën e ligjit 119/2014 është një detyrim që i ngarkohet institucionit publik që prodhon dhe jep informacionin (caktimi i koordinatorit, mbajtja e regjistrat, publikimet proaktive, etj). Gjithashtu, ky vlerësim nuk mat aspekte të konsultimit publik apo të vendimarrjes me pjesëmarrje, të cilat janë edhe ato pjesë e transparencës qeverisëse. Fakti është se çështjet e konsultimit publik normohen me ligj të posaçëm në RSH, dhe konkretisht me ligjin nr. 146/2014. Po ashtu, çështjet e pjesëmarrjes në vendimarrje në nivel të qeverisjes vendore (në bashki) normohen me ligjin 139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”.

Monitorimi i parë kombëtar i të drejtës së informimit në nivel të qeverisjes vendore u mbështet nga Qeveria Suedeze përmes Olof Palme Center. Gjetjet u bënë publike në datë 3 Maj 2016, datë e cila përkoi edhe me ditën ndërkombëtare të Medias (lirisë së shprehjes), e cila evokon ligjin e parë anti-censurë në botë, miratuar në Suedi në vitin 1766 (*Freedom of the Press Act*, *Konglige Majestäts Nådige Förordning, Angående Skrif- och Tryck-friheten*)

Në vitin 2017, INFOCIP ndërmori një monitorim të dytë kombëtar për të verifikuar progresin pas rekomandimeve që la Raporti i parë. Edhe ky monitorim u mbështet nga Qeveria Suedeze përmes Olof Palme Center ndërkohë që gjetjet u bënë publike në një konferencë kombëtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të gjithë organizatave të shoqërisë civile që punojnë në nivel lokal, pjese e rrjetit të OPC. Në këtë event mori pjesë dhe Ambasadori i Suedisë në Shqipëri, Sh.T. Z. Johan Ndisi si dhe përfaqësuesit të UN në Tiranë, SH.T.Z. Brian Williams. Po ashtu në këtë event moren pjesë edhe kryetarët e bashkive me rezultatet më të larta në vlerësimin e realizuar nga INFOCIP, konkretisht, kryetari i bashkisë Tiranë, Z. Erjon Veliaj, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, Znj. Voltana Ademi, kryetari i bashkisë Korçë, Z. Sotiraq Filo. Gjetjet e këtij monitorimi u shpallën në Shtator 2017, në prani të Komisionerit për të Drejtës për Informim dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, Z. Besnik Dervishi.

Monitorimi nga INFOCIP i mekanizmit mundësues të së drejtës së informimit në 61 bashkitë e Shqipërisë ka shërbyer për nxitjen e nismave të tjera të ngjashme nga aktorët e sektorit jo-qeveritar. Ky është një ndër indikatorët e suksesit në drejtim të vlerësimit të zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga aktorët e sektorit të shoqërisë civile.

INFOCIP, i vetëdijshëm për rolin që luan në drejtim të promovimit të kësaj të drejte të rëndësishme, ka realizuar edhe vlerësimin e trete kombëtar, gjetjet e të cilin bëhen publike në këtë botim. Fotografimi i plotë i situatës së implementimit të infrastrukturës zbatuese të ligjit që në vitin 2016 ka krijuar mundësi që gjetjet e 2017-ës dhe 2018-ës të mund të indikojnë progresin e arritur në këtë drejtim. Metodologjia e përdorur është e njëjtë, për të ruajtur bazën krahasuese të të dhënave si dhe për të dalë në konkluzione sa më objektive mbi progresin e shënuar.

IV. MBI METODOLOGJINË DHE INDEKSIN

Objekt matje dhe vlerësimi janë 5 komponentë që përbëjnë kusht parësor infrastrukturor për implementimin dhe zbatimin e ligjit 119/2014 në nivel të qeverisjes vendore dhe konkretisht:

- 1) **Pasja e faqeve zyrtare të internetit** (max 2 pike)
- 2) **Regjistri i Pyetje-Përgjigjeve** (max 1 pike)
- 3) **Kordinatori i të drejtës për informim** (max 2 pike)
- 4) **Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak** (max 2 pike)
- 5) **Hartimi/Publikimi i programit të transparencës** (max 3 pike)

Në kuadër të metodologjisë që aplikon INFOCIP, faqet e internetit konsiderohen infrastrukturë bazë për përmbushjen e kërkesave të ligjit 119/2014 në realizimin e informimit pro-aktiv (pa kërkesë) nga bashkia. Për shkak të larmisë së informacionit që jepet pa kërkesë, afishimi i tyre në stenda do të ishte jo-praktik. Për më tepër, bashkitë, edhe për shkak të RAT, kanë nën juridiksion terriore të shumëfishuara, ku gjysma e popullsisë jeton jashtë vijave të verdha (në fshatra, terriore të ish-komunave). Marrja e informacioneve përmes standës së bashkisë në këtë kuptim do të ishte jo-praktike dhe jo-efikase.

Është e qartë se mungesa e infrastrukturës bazë, faqet zyrtare të internetit, do të kompromentonte zbatimin rigoroz të blloqeve të tjera, pasi ligjvënësi ka impikuar qartësisht aksesin efektiv online sidomos për programet e transparencës, të cilat përmbajnë edhe grupin më të rëndësishëm të informacioneve që bëhen publike pa kërkesë.

Blloqet infrastrukturorë të mësipërme janë një detyrim i pastër ligjor ndaj bashkive. Mos-implementimi i tyre i ngarkon ato me përgjegjësi përpara ligjit, por edhe ndaj autoritetit mbikqyrës, i cili në këtë rast ka tagrin të aplikojë sanksione ndaj kordinatorëve dhe madje edhe ndaj krerëve të bashkive.

Ligji 119/2014 “Për Informimin Publik” i cakton detyrimin autoritetit publik, në rastin konkret bashkive, që të mbajnë dhe të përditësojnë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve (Neni 8). Ky është një regjistër i posaçëm ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Sipas ligjit 119/2014, regjistri përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Ligji 119/2014 i cakton Autoritetit Publik, në rastin tonë bashkive, detyrimin për caktimin e koordinatorëve të informimit publik. Ky është një person kyç i administratës bashkiake në implementimin e kërkesave të ligjit dhe që mban përgjegjësi direkte në rast mos-përmbushjeje. Të dhënat e koordinatorit duhet të afishohen publikisht, në faqen zyrtare të bashkisë (neni 7/1, gërma “ç”).

Sa i takon vendimeve të keshillave bashkiake, ato janë aktet më të rëndësishme me të cilat disponojnë bashkitë dhe publikimi i tyre është një kërkesë e dyfishtë që buron si nga interpretimi i neneve të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, ashtu dhe nga përcaktimet eksplicite të ligjit 139/205 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Për të lehtësuar kuptimin nga Media dhe nga publiku të të dhënave që sjell ky studim, INFOCIP ka krijuar një sistem pikëzimi që është i njëjtë (analog) me vlerësimin klasik në sistemin tonë arsimor, pra nga 1 deri në 10. Pas aplikimit të vlerësimit me pikë, INFOCIP ka listuar (*ranking*) 61 bashkitë sipas rezultatit të grumbulluar, duke filluar nga nota më e lartë tek nota më e ulët. Renditja e vitit 2016 ka caktuar ndërkohë terrenin “zero” nga i cili mund të matet progresi/regresi për vitin 2016, 2017, 2018 e më tej. Ky sistem përfaqëson edhe indeksin kombëtar të implementimit të kërkesave të ligjit 119/2014 “Për të drejtën për Informim” në RSH nga institucionet publike, në rastin konkret organet e pushtetit vendor.

Vlen të theksohet këtu se Indeksi i INFOCIP nuk mat dhe as nuk vlerëson cilësinë e ndërveprimit të subjektit me autoritetin publik, por ndërveprimin e këtij të fundit me kërkesat ligjore në terma të implementimit të infrastrukturës zbatuese të ligjit 119/2014.

Studimi merr në analizë cilësore të posaçme **programet e transparencës** që duhet të jenë të përgatitura/adoptuara dhe të afishuara nga bashkitë. Kjo analizë u testua për herë të parë në vlerësimin e parë kombëtar që INFOCIP realizoi në vitin 2016 (shpallur në 3 Maj 2016). Në vitin 2016 analiza cilësore e programeve të transparencës nuk kishte efekt mbi sistemin e pikëzimit, pasi në renditjen finale, edhe për programin e transparencës aplikoheshin metoda binare e vlerësimit (është ose nuk është). Në vlerësimin e 2017-ës dhe tashmë të 2018-ës çdo kategori informacioni që ai përmban pikëzohet në vlerësim (30 pikë të mundshme gjithsej). Shuma kumulative ponderohet me koeficientin 0.1 dhe maksimumi i vlerësimit për një program të kompletuar transparence është 3 pikë (në vlerësimin final kumulativ). Ky lloj vlerësimi nuk merr përsipër të vlerësojë shkallën e gatishmërisë së bashkive (kohëzgjatjen, cilësinë e informacionit, etj) për të dhënë informacion përmes vënies në lëvizje përmes kërkesave për informim (informimi aktiv).


KAPITULLI 1

GJETJET E MONITORIMIT 2018


1. FAQET E INTERNETIT

Në kuadër të metodologjisë që aplikon INFOÇIP, faqet e internetit konsiderohen infrastrukturë bazë për përmbushjen e kërkesave të ligjit 119/2014 në realizimin e informimit pro-aktiv (pa kërkesë) nga bashkia. Për shkak të larmisë së informacionit që jepet pa kërkesë, afishimi i tyre në stenda do të ishte jo-praktik. Për më tepër, bashkitë, edhe për shkak të RAT, kanë nën juridiksion terriore të shumëfishuara, ku gjysma e popullsisë jeton jashtë vijave të verdha (në fshatra, terriore të ish-komunave). Marrja e informacioneve përmes standës së bashkisë në këtë kuptim do të ishte jo-praktike dhe jo-efikase.

Nga vlerësimi i ndërmarrë deri në Shtator 2018, rezulton se nga 61 bashki vetëm 54 prej tyre kanë faqe interneti. Prej tyre, 48 kanë faqe me domain institucional **“.gov.al”** (me ngjyre jeshile ne hartë), kurse 6 bashki kanë faqe, por me domain të zakonshëm (.org ose .com ose .al). Nga vlerësimi rezulton se në vitin 2018, janë vetëm 7 bashki që nuk kanë fare prezencë zyrtare online (shënuara me ngjyrë të kuqe në hartë). Disa prej këtyre bashkive kanë gjithsesi faqe në Facebook, por në kuadër të kësaj metodologjie ato nuk përlloragriten si faqe zyrtare. Vlen të përmendet se shumë bashki, përveç faqes zyrtare, kanë edhe faqe në rrjetet sociale, që në shumicën e rasteve është e integruar si link në faqen zyrtare.




KATEGORITE	PIKE
<i>Bashki që nuk kanë website</i>	0
<i>Bashki me website të pa-përditësuara prej 1 viti</i>	1
<i>Bashki me website aktiv me domain të çfarëdoshëm</i>	1.5
<i>Bashki me website aktiv me domain zyrtar .gov.al</i>	2



1.1. KRAHASIMI 2016-2017-2018 DHE PËRLLOGARITJA E TRENDIT .

Bashkitë të cilat përdorin faqe zyrtare interneti u shtuan në vitin 2018, krahasuar me dy vite më parë. Konkretisht, nga vetëm 24 bashki me faqe zyrtare interneti në 2016 (39% e gjithë bashkive) dhe 48 bashki në 2017-ën (ose 79%) në 2018 numërohen 54 bashki ose 89%. Kjo do të thotë se ky tregues është përmirësuar me rreth 10 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Shumica e bashkive që kanë krijuar një faqe internet në vitin 2018 kanë përdorur një template të posaçëm (*town press*). Ky template është ende në zhvillim në të paktën 4 bashki. Ai është pilotuar nga INFOCIP fillimisht në Bashkinë e Gramshit, e më pas në bashkinë e Pukës dhe gjatë vitit 2018 edhe në disa bashki të tjera. INFOCIP po punon aktualisht që ky *template*, për shkak të lehtësive që ofron në konfigurimin zyrtar të të dhënave të bashkive të kompletojë është ato pak bashki që nuk kanë një system zyrtar online apo kanë sisteme që nuk përmbushin siç duhet funksionet e synuara/kërkuara.



1.2. REKOMANDIME:

- 1) *Bashkitë e identifikuara më sipër duhet të pajisen sa më parë me Faqe Zyrtare interneti. Komisioneri i të Drejtës për Informim dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, apo aktorë të tjerë të interesuar,*
- 2) *Bashkitë që kanë faqe interneti, por të cilat janë me domain jo-zyrtar, iu rekomandohet që të kalojnë databazat e tyre në domain zyrtar, i cili në këtë rast garantohet nga AKEP.*
- 3) *Qeveria shqiptare apo organizata/ donatore ndërkombëtarë, brenda mundësive, të facilitojë procesin e pajisjes së tyre me infrastrukturën e domosdoshme për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga përcaktimet e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*
- 4) *Modelet e faqeve të internetit të përafrohen gradualisht drejt një modeli të standartizuar, i cili të reflektojë më mënyrë sa më optimale kërkesat ligjore në fuqi.*
- 5) *Bashkitë për përcaktojnë në organikën e tyre personel të përhershëm që të përmbushë funksionet e përditësimit të sistemeve online, përfshirë edhe faqen zyrtare të internetit.*



2. REGJISTRI I KERKESAVE & PERGJIGJEVE

Ligji 119/2014 “Për Informimin Publik” i cakton detyrimin autoritetit publik, në rastin konkret bashkive, që të mbajnë dhe të përditësojnë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve (Neni 8). Ky është një regjistër i posaçëm ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Sipas ligjit 119/2014, regjistri përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Nga vlerësimi i ndërmarrë nga INFOCIP në shkallë kombëtare, rezulton se vetëm 35 bashki nga 61 gjithsej kanë të afishuar në faqen zyrtare të internetit regjistrin e pyetje përgjigjeve. Harta e mëposhtme tregon shtrirjen e kësaj infrastrukture në bashkitë e Shqipërisë. Regjistrat të cilët gjenden të publikuar janë në shumicën e tyre të përditësuar. Konkretisht, deri në shtator 2018, rezultuan vetëm 19 regjistra të përditësuar nga 35 gjithsej.


Bashkitë me regjistra të përditësuar në vitin 2018 janë **Devoll, Dibër, Dropull, Durrës, Gramsh, Kamëz, Kavajë, Korçë, Kurbin, Lezhë, Maliq, Mallakastër, Mat, Patos, Përmet, Shkodër, Skrapar, Tiranë, Vlorë**. Janë 16 regjistra të cilat përditësimin e fundit e kanë marrë në 2016 dhe 2017. Regjistrat që i takojnë bashkive Malësi e Madhe dhe Roskovec përditësimin e fundit e kanë në 2016-ën. Bashkitë Bulqizë,

Elbasan, Fier, Himarë, Krujë, Kukës, Librazhd, Lushnje, Peqin, Pogradec, Shijak, Tropojë, Ura Vajgurore dhe Vorë përditësimin e fundit e kanë në 2017-ën.



2.1. KRAHASIMI 2016-2017-2018 DHE PËRLLOGARITJA E TRENDIT

Gjatë vitit 2018, më shumë bashki kanë plotësuar kërkesat e ligjit 119/2015 për mbajtjen dhe publikimin e regjistrit të pyetje përgjigjeve. Gjatë 2018-s, ka 9 bashki më shumë sesa në vitin 2017 që kanë një regjistër të pyetje-përgjigjeve duke pësuar një rritje prej **13 pikë përqindje**. Treguesi në fjalë u përmirësua gjatë vitit 2017 me 36 pikë përqindje krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, ky tregues është ndër më pak të zbatuarit nga të 5 komponentët që vlerëson INFOCIP, me vetëm 57 pikë përqindje, sikurse sugjeron grafiku më poshtë.



REKOMANDIM: *Krijimi i një databaze kombëtare për të “akomoduar” regjistrin është tashmë një angazhim i marrë, i cili ka filluar të pilotohet në disa institucione, përfshirë dhe tre bashki të cilat janë identifikuar edhe nga INFOCIP në vlerësimin e vitit 2017 të cilat kanë patur treguesit më të avancuar në implementimin e infrastrukturës së ligjit 119/2014. Lidhur me regjistrin e Kërkesave-Përgjigjeve mund të aktivizohet edhe njëherë të fundit një korespondencë (praktikë shkresore) nga ana e Autoritetit Mbikqyrës, duke prioritarizuar bashkitë që kanë faqe interneti dhe në rast të mospërbushjes së detyrimit ligjor të fillojë aplikimi i sanksioneve ligjore, pavarësisht rezultateve të fazës së pilotimit apo planizimit të fazës pasuese të replikimit të standartit që do të vendoset në tre bashkitë pilot.*

2.2. MBI METODËN VLERËSIMIT:


Në Metodën që përdor ky studim, regjistrat e përditësuar rregullisht gjatë vitit vlerësohen me 1 pikë. Regjistrat të cilët janë të publikuar, por që përditësimin e fundit e kanë marrë në vitin 2017 ose 2016, vlerësohen me 0.5 pikë. Regjistrat e papublikuar në faqen e internetit, vlerësohen me 0 pikë.. Nëse të dhënat e disponuara nga autoriteti mbikqyrës indikojnë prezencën e regjistrave në zyrat e pritjes më publikun, por jo në faqe, për shkak të mungesës së kësaj të fundit, atëherë ky tregues vlerësohet sërish me 0.5 pikë, për shkak se ligji 119/2014 prioritarizon publikimin online të këtij dokumenti, pasi vetëm në këtë mënyrë ai lejon procesimin e kërkesave mbi bazën e precedentit për publikun që kërkon informacion. Në thelb, regjistri i shërben publikut dhe jo administratës. Mbajtja e tij në letër, në kuptimin e këtij vlerësimi është “disi e legjitimuar” vetëm për ato bashki të cilat nuk kanë një faqe zyrtare interneti.

3. KOORDINATORI I TE DREJTES PER INFORMIM NE BASHKI

Ligji 119/2014 i cakton Autoritetit Publik, në rastin tonë bashkive, detyrimin për caktimin e koordinatorëve të informimit publik. Ky është një person kyç i administratës bashkiake në implementimin e kërkesave të ligjit dhe që mban përgjegjësi direkte në rast mos-përmbushjeje. Të dhënat e koordinatorit duhet të afishohen publikisht, në faqen zyrtare të bashkisë (neni 7/1, gërma “ç”). Rezulton se deri në Shtator 2018 në të 61 bashkitë e RSH janë caktuar Kordinatorët për të Drejtën e Informimit. Në ato bashki që nuk kanë faqe interneti, konfirmohet caktimi zyrtar i koordinatorit nga zyrtarët eprorë të kontaktuar nga INFOCIP për qëllime të këtij monitorimi ose/dhe nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtës për Informim (të dhënat e tyre janë të afishuara edhe në portalin www.pyetshtetin.al). Ndërkohë, vlen të theksohet se në të 54 Bashkitë që kanë faqe interneti, vetem ne 37 prej tyre janë të publikuara edhe kontaktet e koordinatorëve. Bashkitë që nuk i kanë të publikuara kontaktet janë Belshi, Finiq, Fushe Arrez, Gjirokaster, Kavaje, Klos, Konispol, Kucove, Kukes, Memaliaj, Mirdite, Permet, Pustec, Sarande, Tepelene, Tropoje dhe Vau i dejes.




Grafiku me poshtë ofron nje paraqitje alternative të implementimit nga ana e 61 bashkive te komponentit te koordinatorëve gjatë vitit 2018



3.1. KRAHASIMI 2016-2017-2018 DHE PËRLLOGARITJA E TRENDIT

Për sa i përket vitit 2018, të 61 bashkitë e RSH kanë koordinator për të drejtën e informimit duke bërë të mundur realizimin në masën 100% të këtij komponenti. Për vitin 2016, vlerësimi konstatoi se ishin caktuar nga bashkitë vetëm 40 koordinatorë. Në vitin 2017, ky tregues pësoi një rritje prej 29 pikë përqindje. Grafiku ngjitur ofron një paraqitje krahasimore të këtij treguesi si dhe trendin rritës së tij edhe për vitin 2018.

Koordinatori i të Drejtës së Informimit 2016 vs. 2017 vs. 2018




4. PUBLIKIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak është një detyrim që buron nga ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe gjithashtu nga ligji organik 139/2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”. Nga vlerësimi i ndërmarrë për vitin 2018, rezulton se të 61 bashkitë publikojnë tashmë vendimet e tyre online. Ky është një tregues tërësisht i plotësuar, falë edhe projektit STAR 2/ UNDP, i cili në bashkëpunim me INFOCIP mbështeti procesin e përfshirjes në një program të dedikuar asistence të 34 bashkive që kishin vështirësi në ofrimin koherent dhe sistematik të këtij shërbimi qeverisës përmes teknologjive online (*me ngjyrë të gjelbër të çelur në hartën e mëposhtme*).


Nga vlerësimi i vitit 2017, rezultonte se nga 61 bashki gjithsej, vetëm 41 prej tyre publikonin vendimet e këshillit bashkiak (67.2%). Një pjesë e mirë e tyre gjithsesi nuk kishin koherencë në

publikimin e VKM-ve ndërkohë që disa të tjera mjaftoheshin vetëm me publikimin e titullit të aktit. Deri në vitin 2012, asnjë bashki, me përjashtim të Tiranës, nuk publikonte vendimet e këshillit bashkiak në asnjë lloj forme të njohur. Kurse në vitin 2016, vetëm 20% e gjithë bashkive të Shqipërisë publikonin vendimet e veta; nga këto, rreth 87% e tyre publikonin përmes platformës kombëtare VENDIME.AL të ndërtuar dhe të administruar nga INFOÇIP.

Vlen të theksohet se bashkitë Shkodër, Lezhë, Tiranë, Mat, Dropull, Roskovec, Vore, Ura Vajgurore, Fier, Elbasan, Vau Dejës, Krujë dhe Mirdite kanë publikuar vendimet e tyre në dy sisteme alternative: edhe në faqet e tyre zyrtare dhe në VENDIME.AL (me ngjyrë blu në hartën e mëposhtme). Harta e mëposhtme identifikon shtrirjen gjeografike të publikimit të vendimeve prej 61 bashkive, ku me ngjyrë jeshile janë shënuar bashkitë që publikojnë sipas standartit kombëtar të VENDIME.AL



Harta me poshtë, tregon shpërndarjen gjeografike të bashkive sipas niveleve të vlerësimit që përdor INFOCIP për vlerësimin e këtij treguesi në kuadër të këtij monitorimi kombëtar.




LEGJENDA: Shpjegimi i pikëve/ tabela e vlerësimit

Bashkia nuk publikon vendimet e këshillit bashkiak	Bashki që publikojnë vetëm titujt e vendimeve	Bashki që publikon vendimet jo-rregullisht	Bashki që publikon rregullisht vendimet në faqen zyrtare ose VENDIME.AL
0 pikë	0.5 pike	1 pike	2 pikë

4.1. KRAHASIMI 2016-2017-2018, PUBLIKIMI I VENDIMEVE TE KËSHILLIT

Nga Monitorimi rezulton se gjatë 2018-ës të 61 bashkitë ose 100% e tyre publikojnë vendimet e tyre online. Ky tashmë konsiderohet edhe si standarti i gjithëpranuar për ofrimin e shërbimit të njoftimit të akteve. Një rol të rëndësishëm në unifikimin e këtij standarti ka luajtur Platforma Kombëtare VENDIME.AL. Popullimi i kësaj platformë me 61 bashki brenda vitit 2018 ishte një ndër objektivat shtetit shqiptar të parashkuar në Planin e Tretë Kombëtar të Veptimit, në kuadër të OGP. Në vitin 2016 vetëm 12 bashki nga 61 të tilla (19.67%) publikonin vendimet e tyre. Në vitin 2017 ky tregues pati rritje me 47.5 pikë përqindje duke e çuar numrin e bashkive që publikonin vendimet e tyre në 41. Pavarësisht këtij numri, rreth 34 bashki kishin probleme në rregullsinë e publikimit dhe në standartin e përdorur për këtë qëllim. Gjatë vitit 2018 u bë e mundur që të 61 bashkitë të publikonin vendimet e tyre, edhe falë kontributit direkt të Projektit STAR 2/ UNDP që ka marrë përsipër të avancojë objektivat qeveritarë të përcaktuara në Strategjinë e Decentralizimit 2015-2019.



Platforma VENDIME.AL ka dhënë një kontribut real në unifikimin e këtij standarti dhe ka mundur që edhe bashkitë që nuk kanë patur mundësi të realizojnë publikimin e vendimeve më parë, të arrijnë që të përbushin me korrektësi këtë shërbim gjatë vitit 2018. Aktualisht INFOÇIP, si pjesë e anagazhimeve në kuadër të STAR 2, synon që ky proces të jetë tërësisht i vetë-qëndrueshëm brenda vitit 2019.

Deri një vit më parë, publikimi përmes VENDIME.AL ka qenë alternativa e vetme për shumë bashki të mesme dhe të vogla për të njoftuar vendimarrjen e tyre subjekteve të interesuara, duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe kohën e hyrjes në fuqi të akteve.

Publikimi online i vendimeve të këshillave bashkiakë është bërë edhe më i domosdoshëm në kushtet e reja të krijuara nga Reforma Administrativo-Territoriale, për të realizuar efektivisht njoftimin e akteve, që përbën edhe një shërbim bazë të qeverisjes.

VENDIME.AL është kthyer në një *locus* ndërveprimi për aktorët vendimarrës, një platformë ku shkëmbehet përvojë qeverisëse. Ajo cakton një premisë të rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e vendimarrjes, sidomos të bashkive të reja të krijuara në kuadër të Reformës Administrativo-Territoriale.

VENDIME.AL i shërben koordinatorëve të të drejtës për informim për të performuar siç duhet funksionet e rëndësishme që ligji iu ngarkon atyre për njoftimin e vendimarrjes subjekteve nën juridiksion të bashkisë. Platforma VENDIME.AL duke qenë e hapur në çdo kohë dhe e përdorshme pa pagesë, i lejon stafeve administrative në bashki të adoptojnë praktikën më të mirë në formulimin e projekt-vendimeve.

VENDIME.AL i shërben edhe institucioneve qendrore (Kuvendi, Qeveria përmes Prefekteve etj) për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me vendimarrjen e qeverisjes vendore. Po ashtu, platforma i vjen në ndihmë të gjitha institucioneve apo agjensive të tjera qendrore në nivel vendor që ndërveprojnë me bashkinë (prefekti etj).

VENDIME.AL i shërben së fundmi të gjithë aktorëve të tjerë të interesuar në nxitjen dhe promovimin e vendimarrjes vendore përmes inovacionit dhe teknologjive ICT, të cilat ofrojnë shpejtësi në diseminim, reduktim të kontaktit mes zyrtarëve dhe publikut si dhe mbulim të gjerë. Ajo promovon më së miri parimet e informimit proaktiv të publikut, i cili është i gjendshëm në rrjet në çdo kohë, në format të përdorshëm, dhe pa pagesë.

Së fundmi, VENDIME.AL është një angazhim konkret, i ndërmarrë institucionalisht nga Qeveria shqiptare, si objektivi për t'u realizuar dhe raportuar në kuadër të Planit të Tretë Kombëtar të Venprimit në kuadër të Open Government Partnership (OGP). Ky objektivi, për herë të parë në historinë e Shqipërisë, u mor përsipër të përmbushej nga një aktor i shoqërisë civile, duke dhënë kuptim të ri dhe një domethënie të veçantë përpjekjes disa-vjeçare për transparencë që ka bërë INFOÇIP në këtë drejtim së bashku me organizatat partnere që punojnë në nivel Kombëtar (OPC, IDM, OSFA) dhe në nivel lokal. Ky është tashmë një objektivi i realizuar me sukses dhe është i verifikueshëm nga cilido aktor i interesuar.

VENDIME.AL përmbush më së miri kushtet edhe lidhur me standartizimin e shërbimeve të qeverisjes vendore. Sikurse u theksua pak më lart, në kushtet e Post-RAT është imperative aplikimi i standarteve të unifikuara në ofrimin e shërbimeve dhe VENDIME.AL është shembulli konkret se si me pak para, por me shumë pasion dhe dedikim, mund të arrihen standarte të avancuara kombëtare të cilat mbartin vlera unike edhe në rajon e më gjerë. VENDIME.AL përbën sot standartin kombëtar të publikimit të vendimeve të këshillave bashkiake, duke plotësuar në këtë mënyrë jo vetëm një objektivi në kuadër të OGP, por edhe disa objektiva të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit 2015-2019, të miratuar nga Qeveria Shqiptare.

5. PROGRAMET E TRANSPARENCËS

Program Transparence quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë⁴. Sipas ligji 119/2014, autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit ose nga krijimi i tij, ka detyrimin ligjor të vërë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni (neni 4/1). Në rastin e bashkive, ky program miratohet si fillim me vendim të këshillit bashkiak.

Në përgatitjen e projekt-programit të transparencës, bashkia mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos: a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik; b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion; c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për MDHP dhe të Drejtën e Informimit, sipas nenit 6 të ligjit 119/2014. Komisioneri miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 6). Sipas udhëzimeve online⁵, të bëra publike nga autoriteti mbikqyrës, programet e transparencës duhet të jenë krijuar në çdo bashki që pas datës 6 maj 2015 dhe duhet të jenë publikuar në faqet e tyre të internetit. Këto programe duhet të përmbajnë:

- a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;*
- b) tekstet e plota të konventave të ratifikuara, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të çdo dokumenti politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*
- c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;*
- d) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorsit për të drejtën e informimit;*
- e) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;*
- f) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;*
- g) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.*
- h) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit*

⁴ <http://pyetshtetin.al/cfare-quhet-program-transparence/>

⁵ <http://pyetshtetin.al/cfare-quhet-program-transparence/>

publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjore në fushë, duke përfshirë: (i) listën e kontratave të lidhura; (ii) shumën e kontraktuar; (iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; (iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

j) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet e shërbimit;

k) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

l) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyrë tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

m) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

n) një kopje të përditësuar të Rregjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;

o) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfutur ato;

p) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

q) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.


Programet e transparencës (shkurt më poshtë: PT) vlerësohen si në terma të pranisë së tyre online (vlerësimi formal) ashtu dhe në terma të cilësisë së përmbajtjes së tyre në kuadër të këtij monitorimi (vlerësim cilësor). Për programet e secilës bashki u ndërmor një vlerësim cilësor i informacioneve që ai përmban në Shtator 2018. Për të lehtësuar procesin e pikëzimit, informacionet e kërkuara nga germat “p” dhe “q” nuk përfshihen në këtë vlerësim pasi përfaqësojnë vështirësi objektive në matje. Në metodologjinë e përdorur për këtë qellim, çdo gërmë (nga “a” në “o”) përfaqëson një indikator dhe pikëzohet në tre nivele:

I publikuar plotësisht	Pjesërisht i publikuar	Jo i publikuar
2 pikë	1 pikë	0 pikë

Programi i Transparencës i vlerësuar me këtë metodologji grumbullon 30 pikë të mundshme. Pikët kumulative (max 30) për PT indeksohen duke u pjesëtuar me koeficientin 0.1. Ky koeficient synon të përputhë metodologjikisht vlerësimin sasior të prezantuar për Faqet Zyrtare, Koordinatorin, Regjistrin e Pyetje-Përgjigjeve dhe Vendimet me vlerësimin e posaçëm që realizohet në këtë rast për Programin e Transparencës (si një sistem kumulativ pikëzimi). Konkretisht, nëse një bashki grumbullon 25 pikë në total gjatë vlerësimit cilësor të programit të saj të transparencës, atëherë në vlerësimin e përgjithshëm, në kolonën për programet e transparencës, ajo do të rezultojë me 2.5 pikë, të cilat do të mbliidhen më pas me pikët e grumbulluar respektivisht për komponentet e tjere te vlerësimit.


Nga 54 bashki gjithsej që kanë faqe interneti, mundësinë për të validuar një program transparence, pavarësisht se si është i organizuar ai (në një kategori të vetme apo i shpërndarë në disa katëgori brenda faqes) e ofrojnë vetëm 52 bashki.

Ndër këto, vetëm 41 kanë një kategori të dallueshme në faqe me titullin “Program Transparence”, ndërsa 11 bashkitë e tjera kanë vetëm pjesë te elementëve të Programit të Transparencës. Në të vërtetë, ky i fundit mund të performohet optimalisht online, për shkak se çdo formë tjetër e njohur (stendë, apo paper-based) do të ishte objektivist shume e limituar për të përmbushur kërkesat që lidhen me publikimin pro-aktiv të këtij *set-i* dokumentash (*ligje, vendime, organigrama, kontrata, etj*).



LEGJENDA

- Bashki që kanë PT të plotë
- Bashki që kanë PT të pjesshëm
- Bashki që nuk kanë PT



Lidhur me vlerësimin cilësor, INFOÇIP ka renditur në Kapitullin 2 të këtij studimi bashkitë që kanë PT apo elementë të tij të publikuar online. Vlerësimi në këtë rast është aplikuar ndaj përmbajtjes dhe jo ndaj formës së organizimit të Programit të Transparencës. Për periudhën në të

